REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1001 / 20
Datë/Datum. 23.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Punëve të Brendshme

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	**214-20-7360-1-1-1**
Nr i brendshëm	**214/20/104/111**

Sa i përket tenderit për: Furnizimi dhe implementimi me Licenca të Microsoft-it për nevoja të Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Edukimit

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **Botek shpk**

Adresa : **Rruga "Agim Ramadani", Nr. 517, *Prishtinë, 10 000***

Numri Telefonit/ Numri i Faks-it: **038/245830 / 038/245625**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Hilmi Asllani**

Adresa elektronike: **hilmi.asllani@bo-tek.com**

Data e parashtrimit të ankesës: 23.11.2020 **Nënshkrimi dhe vula:**_____

IT, Communication - Energy
BOTEK sh.p.k.
Prishtinë, Republika e Kosovës, 2015

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë "apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **B05 Njoftimi për kontrate: 09.11.2020**
- **Afati i fundit për dorëzim te tenderit: 24.11.2020 ora 11:00**
- **Kriteri për dhënien e kontratës : Çmimi më i ulët.**
- **Sqarime shtesë nga AK, 17.11.2020, ora 14:59.**
- **Sqarime shtesë nga AK, 18.11.2020, ora 15:56.**
- **Sqarime shtesë nga AK, 19.11.2020, ora 16:00.**
- **Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës së e-Prokurimit- 20.11.2020.**
- **Përgjigja nga Ak, mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, 23.11.2020.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja bëhet me datë 24.11.2020

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ Jo ☐

Nuk aplikohet

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo ☐

Me datën 20.11.2020 përmes platformës se e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme.

Me datë 23.11.2020 kemi pranuar vendimin nga AK mbi Refuzimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:

- Neni 7 i LPP-së nr 04 L 042, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim.

- Neni 28 i LPP-së nr 04 L 042, paragrafi 2, Specifikimet teknike.

- Neni 44 i LPP-së 04 L 042, Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 20.11.2020, kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim tek AK-Ministria e Punëve të Brendshme, ku kemi shfaqur ankesën tonë lidhur me kriterin diskriminues, të cilin AK përmes Sqarimeve shtesë të datës 18.11.2020 ka bërë ndryshim esencial te Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.2, ku u ka "mundësuar" OE që: " *për edukim pranohen të gjitha llojet e kontratave të ripërtritshme të furnizimit të licencave të Microsoft-it, për personel të edukimit që përmbajnë së paku gjysmën e sasisë së planifikuar të produkteve (licencave) të cilat janë pjesë e kësaj procedure të fushës së edukimit*". Ky kriter i cili edhe

fillimisht ishte diskriminues, u përmirësua dhe u përshtat, duke favorizuar vetëm një OE të caktuar në Kosovë, i cili në 3 vitet e fundit kishte furnizuar MAP/ASHI me licenca të tilla, duke përjashtuar kështu të gjithë OE potencial dhe konkurrues në tenderë.
Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe të nenit 44 të LPP nr 04 L 042, në rastin e vendosjes së afatit për dorëzim të ofertave. Duke pasur parasysh se tenderi në fjalë është për Kontratë Publike me vlerë të madhe (12,000.000.00 €), sipas ligjit AK do duhej që të caktoj një afat kohor për pranimin e tenderëve jo më pak se dyzet (40) ditë. Ndërsa AK ka vendosur afat 15 ditë për dorëzim nga data e publikimit të B05 Njofitmi për Kontratë.

Ne poashtu kemi kërkuar zgjatjen e afatit për dorëzim të ofertave, pas kërkesave për rishqyrtim dhe sqarimeve shtesë, sikurse është edhe e rregulluar me ligj dhe rregulloret në fuqi të Prokurimit Publik (UOPP A02, pika 22.5) : *"Nëse, gjatë një procedure të hapur, të kufizuar apo negociuar pas publikimit të Njoftimit për Kontratë, informata shtesë apo sqaruese ofrohen për OE-të, dhe data kur ofrohen këto informata është më pak se **dhjetë (10) ditë** nga afati i fundit për dorëzim të tenderit, AK do të zgjatë afatin kohorë për të dhënë mundësi OE të paktën 10 ditë për dorëzimin e tenderëve dhe do të dërgojë njoftimin e tillë të gjithë OE të cilët kanë pranuar DT"*. Ndërsa AK nuk ka zgjatur afatin për dorëzim të ofertave, pavarësisht asaj që sqarimin e fundit e ka publikuar me datë **19.11.2020, në ora 16:00**, duke pamundësuar kështu edhe afatin për Kërkesë për Rishqyrtim.

Bazuar në këto shkelje të AK-Ministria e Punëve të Brendshme, kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së që të obligojë AK të bëjë ndryshimin te Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.2, duke e kthyer atë sikurse ka qenë në fillim, si dhe të shtyejë afatin për dorëzim të ofertave.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet e shkaktuara me rastin e përgatitjes së Kërkesës për Ri-shqyrtim te Autoriteti Kontraktues dhe Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

1. **B05 Njoftimi për kontrate, datë 09.11.2020.**
2. **Sqarime shtesë nga AK, 17.11.2020, ora 14:59.**
3. **Sqarime shtesë nga AK, 18.11.2020, ora 15:56.**
4. **Sqarime shtesë nga AK, 19.11.2020, ora 16:00.**
5. **Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës së e-Prokurimit- 20.11.2020.**
6. **Përgjigja nga Ak, mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, 23.11.2020.**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*